

Pse kaq shumë shkencëtarë pajtohen me teorinë e evolucionit?

Gjatë njëqind viteve të fundit është bërë një progress i pamasë në të kuptuarin shkencor, duke na aftësuar që ta dërgojmë njeriun në hënë, të kurojmë shumë sëmundje dhe të projektojmë kompjutera me shpejtësi marramendëse të përpunimit të të dhënave. Kjo i bën shumë njerëz të besojnë se shkencëtarët janë po aq kompetentë për të shpjeguar historinë dhe madje edhe fillimet e jetës në tokë; por nuk është kështu.

Ta dërgosh njeriun në hënë, të kurosh ose të parandalosh sëmundjet dhe të projektosh kompjutera kërkon kompetencë në *shkencat operative*, që do të thotë një të kuptuar të ligjeve natyrore, e cila mund të merret përmes vëzhgimeve të kujdesshme dhe eksperimenteve në të tashmen. Ka shumë njerëz në institucionet e kërkimeve shkencore dhe zhvillimit kudo nëpër botë, që janë shumë të mirë me këtë, për të cilët dëshmon sukcesi për shkencën operative. Megjithatë, përpjekjet për ta kuptuar historinë e jetës, kërkojnë kompetencë në *shkencat historike* ose të *origjinës*, që është më e ngjashme me punën e një shkencëtari detektiv ose mjeko – ligjor. Është shumë më e vështirë se sa shkencat operative, për shkak se shpesh ne nuk mund t'i provojmë hipotezat tona me anë të eksperimenteve dhe mbështetemi mbi supozime. Është gjithashtu shumë më e vështirë se sa shkencat mjeko-ligjore për shkak se ne nuk marrim ndihmë nga dëshmitarët okularë, sepse çështjet lidhen me atë që ka ndodhur kaq larg memories së gjallë.¹ Për këtë arsye ne jemi shumë më pak kompetentë në shkencat historike, për të cilat dëshmon mosmarrëveshja mes shkencëtarëve në lidhje me çështjet themelore dhe rishikimi konstant dhe në shkallë të madhe i teorive të tyre. Për shembull, Profesori Ager, pranoi se, 'Duhet të jetë e rëndësishme që të gjitha historitë e evolucionit që kam mësuar si student ... tani janë bërë "të diskredituara".² Në mënyrë të ngjashme, Uilliam Provain [William Provine], Profesor i Shkencave Biologjike në Universitetin Kornell, shkroi, 'Shumica e

Pse kaq shumë shkencëtarë pajtohen me teorinë e evolucionit?

asaj që mësova në fushën e biologjisë evolucioniste në shkollën pas-universitare (1964-68) është ose e gabuar, ose ka ndryshuar në mënyrë të rëndësishme.³

Është e rëndësishme të vërehet kujdesi i ndërmarrë nga shkencëtarët kur bëjnë deklarata për shkencën operative, ngaqë ata e dinë se ajo që thonë mund të jetë subjekt testimesh, dhe nëse është e gabuar, të dalë e rreme. Ata ndihen shumë më të lirë për të bërë deklarata për origjinën për shkak se, shumë shpesh, askush nuk mund të provojë se ata e kishin gabim. Për më tepër, Për shkak të natyrës jo precize të shkencës mbi origjinën, ajo mund të keqpërdoret në të njëjtën mënyrë që disa i keqpërdorin studimet mbi historinë e njerëzimit, duke përzgjedhur vetëm ato dëshmi që i përshtaten objektivit ideologjik ose politik të cilin ata dëshirojnë ta përkrahin.

Shkenca historike është në mënyrë të pashmangshme e varfër në të dhëna dhe kjo është njëra nga arsyet se përse evolucionistët dhe kreacionistët, duke përdorur të njëjtat të dhëna, dhe duke i zbatuar të njëjtët parime shkencore, mund të mbërrijnë në përfundime të kundërta. Ndryshimi i vërtetë mes këtyre dy grupeve qëndron në *interpretimin* që u bëjnë ata të dhënave, gjë që shpesh përcaktohet nga *botëkuptimi* i tyre. Në mënyrë të rëndësishme, evolucionisti i zjarrtë dhe ish Profesori i Biologjisë në Universitetin e Harvardit, Riçard Leuontin [Richard Lewontin], thotë,

Ne mbajmë anën e shkencës, pavarësisht nga absurditeti i dukshëm i disa prej ndërtuesve të saj, pavarësisht nga dështimi i saj për të përmbushur shumë prej premtimeve të saj extravagante për shëndetin dhe jetën, pavarësisht nga toleranca e komunitetit shkencor për ato ngjarjet e parëndësishme të tipit ‘pikërisht kështu’, për shkak se ne kemi një përkushtim prioritar, një përkushtim ndaj materializmit. Nuk është se metodat dhe institucionet e shkencës në njëfarë mënyre na detyrojnë ta pranojmë një shpjegim material të botës fenomenale, por, përkundrazi, se ne jemi të detyruar prej besnikërisë sonë a priori ndaj çështjeve materiale për të krijuar një aparat investigimi dhe një komplet konceptesh që prodhojnë shpjegime materiale, pavarësisht se sa kundër-intuitive janë, pavarësisht se sa misterioze janë ndaj të pafilluarës. Për më tepër, që materializmi është absolute, pasi ne nuk mund ta lejojmë një Këmbë Hyjnore të dera.⁴

‘Dëshmia’ për evolucionin ndodhet jo tek vëzhgimi në natyrë, ose në të dhënat e fosileve, por në *presupozimet* e komunitetit shkencor laik. Së pari, shkenca përkufizohet si diçka që e përjashton të mbinatyrshmen, duke u bazuar vetëm në ligjet natyrore të parashikueshme. Së dyti, debatohet se, ndonëse njohuria

Kapitulli 10

shkencore është e paplotë, ajo ka potencialin për të shpjeguar gjithçka. Prandaj, sipas këtyre dy parimeve, duhet të jetë e mundur të shpjegohet se si lindi jeta përmes proceseve natyrore. Një pjesë e teorisë së evolucionit është hipoteza më tërheqëse nga ana shkencore, dhe çdo vëzhgim që mund të interpretohet sikur e mbështet atë, pranohet me gatishmëri si dëshmi e vlefshmërisë së saj. Vëzhgimet që duket sikur e kundërshtojnë teorinë vihen mënjanë, në pritje se përparimi i mëtejshëm shkencor një ditë do ta shpjegojë se përse ato nuk përbëjnë asnjë problem real. Megjithatë, ky lloj të menduari është në mënyrë demonstruese i pathemeluar. Megjithëse përkufizimi i shkencës se ajo ka lidhje vetëm me proceset natyrore është i arsyeshëm, presupozimi se proceset natyrore shkaktuan gjithçka që ne vëzhgojmë sot në botë nuk është, për shkak se ai nuk mund të provohet. Dhe nëse një teori nuk mund të jetë provuar, ose nuk ka qenë provuar, nuk është shkencore.

Problemet e vërteta dhe të ashpra të shoqëruara me idenë se ngjarjet e rastësishme (me ose pa përzgjedhjen natyrore) mund të kenë shkaktuar proceset evolucioniste kanë qenë njohur për shumë vite. Për shembull, kundërshtime shumë serioze ndaj Teorisë Neo-Darviniane, u prezantuan prej disa shkencëtarëve të shquar në një simpozium në Institutin Wistar, në Filadelfia, që në vitin 1966.⁵ Sipas Kryetarit, zoologut dhe fituesit të çmimit Nobel, Sër Peter Medawar, ‘kundërshtime të tilla janë shumë të përhapura mes biologëve në përgjithësi’.⁶ Në njërin nga shkrimet e tij, matematicieni, Profesori Murray Eden i Institutit të Teknologjisë në Masaçusets shkoi aq larg sa të thoshte, ‘Ne pohojmë se, në qoftë se fjalës “i rastësishëm” i jepet një interpretim serioz dhe kritik nga një pikëpamje probabiliteti, postulati i rastësisë është shumë i pambështetur dhe një teori shkencore mbi evolucionin duhet të presë për zbulimin dhe shpjegimin e ligjeve të reja natyrore – të fizikës, fiziko-kimisë dhe biologjisë.’⁷ Deklarata të tilla janë një pranim i qartë se, për të mbajtur një pozitë evolucionist, është e domosdoshme t’i bëhet thirrje shkencës së *panjohur* (‘ligjeve të reja natyrore’), për shkak se shkenca e njohur tregon se teoritë aktuale nuk funksionojnë.

Duke e diskutuar problemin e origjinës së jetës, Profesori Davies, flet po aq me paanësi: ‘... nga i erdhi forma specifike e informacionit e nevojshme për ta bërë qelizën e parë të gjallë të punonte? Asnjë nuk e di...’;⁸ ‘Asnjë ligj i njohur i natyrës nuk mund ta arrijë këtë...’⁹

Shumë evolucionistë thjesht besojnë *me anë të besimit* se këto ligje të reja shkencore do të zbulohen një ditë. Por a është vërtet e besueshme se ligjet natyrore të afta për të prodhuar diçka aq të ndërlikuar sa truri njerëzor, me ato

dhjetë miliardë qeliza nervore, ku *gjithsecila* nxjerr mes dhjetë mijë dhe njëqind-mijë fibra lidhëse, tani janë të pavëzhgueshme? A janë fshehur këta ligje për një kohë të shkurtër apo përgjithmonë?

Sipas fituesit të çmimit Nobel Harold Urey, i cili është i famshëm për punën e tij në kërkim të të kuptuarit të fillimeve më të hershme evolucioniste të jetës,

... që të gjithë ne që e studiojmë fillimin e jetës zbulojmë se sa më shumë që të kërkojmë thellë për të, aq më shumë e ndiejmë se është tepër e ndërlikuar që të ketë evoluar diku ... Ne që të gjithë besojmë se jeta evoluoi prej lëndës së vdekur në këtë planet. Por ndërlikueshmëria e saj është kaq e madhe, saqë është e vështirë për ne ta imagjinojmë se ajo bëri vërtet kështu.¹⁰

Një arsye tjetër se përse disa pajtohen me teorinë e evolucionit del se është prisioni i kolegëve. Rodney Stark, Profesor i Shkencave Shoqërore në Universitetin Baylor, komentoi, 'Ngurrimi im për t'i ndjekur këto çështje bazohet në përvojën time se asnjë gjë nuk shkakton panik më të madh mes shumë prej kolegëve të mi, se sa ndonjë kritikë ndaj evolucionit. Ata duket se tremben se mos dikush mund t'i marrë ata për kreacionistë nëse ata madje edhe thjesht vetëm sa qëndrojnë në të njëjtën dhomë ku zhvillohet një bisedë e tillë.'¹¹ Secili shkencëtar që e konsideron hapur një pikëpamje të origjinës që është tjetër nga ajo e evolucionit përballet me një tallje të menjëhershme dhe, tepër shpesh, me perspektiva të kufizuara për karrierën. Në disa institucione shkencore, shkencëtarët përballen me përndjekje dhe mund ta humbin vendin e punës, nëse ata e kundërshtojnë hapur teorinë e Darvinit.¹² Përveç ndërlikimeve të dukshme dhe më serioze për fjalën e lirë, kjo mund të jetë një pengesë kryesore për ta treguar të vërtetën, për shkak se diskutimi i hapur është thelbësor për procesin e arritjes së një marrëveshjeje të drejtë.

Evolucionistët debatojnë se teoria e tyre është shkencore për shkak se ajo bazohet mbi zbatimin e ligjeve natyrore, kurse kreacionizmi nuk është shkencore pasi ai bazohet mbi besimin. Në realitet, evolucioni, për shkak të mungesës së dëshmive në mbështetjen e tij, gjithashtu është një vepër besimi dhe është gjithashtu, në shumë aspekte joshkencore, pasi ka kaq shumë argumenta të fortë shkencorë kundër saj. Teoria e evolucionit nuk del nga dëshmitë bindëse por nga një përkushtim për të gjetur një shpjegim për ekzistencën tonë bazuar mbi shkaqet natyrore. Ajo është shkencore vetëm në kuptimin që është një përmbledhje e ideve shkencore prej të cilave shpresohet se një ditë do të ndërto-

Kapitulli 11

het një teori e besueshme shkencore. Fakti se një përpjekje e tillë mund të ketë sukses ndonjë ditë, megjithatë, nuk është më shumë se sa presupozim.

Herë pas here, kur i flas dikujt për evolucionin dhe nis të prezantoj dëshmitë shkencore kundër tij, personi buzëqesh (ndonjëherë me mirësjellje, ndonjëherë me më pak mirësjellje) dhe pyet, ‘Atëherë, si tjetër e shpjegon ti faktin e jetës në tokë?’ Kam gjetur se, kjo pyetje shumë shpesh zbulon arsyen e vërtetë të personit për të besuar në evolucionin—nuk është se dëshmia shkencore e ka bindur atë, por se alternativa (mbinatyrore, krijim i veçantë) është *marrë si i mirëqenë* të jetë absurd. Nuk duket se ndonjëherë atij personi do t’i duket logjike se shpjegimi i Biblës për jetën mund të jetë i sakti. Filip Xhonson [Phillip E. Johnson], Profesor Emeritus i Ligjit në Universitetin e Kalifornisë në Berkeley, arriti në përfundimin se,

... nga përvoja ime personale, është pa kuptim të përpiqesh të përfshish një natyralist shken-
cor në një diskutim lidhur me temën nëse është e vërtetë ose jo teoria Neo-Darviniste e evo-
lucionit... Ta vësh në dyshim nëse vetë evolucionin natyralist është ‘i vërtetë’ ... do të thotë
të flasësh budallallëqe... [Për njerëz të tillë] evolucionin natyralist është i vetmi shpjegim i
besueshëm për jetën, dhe kështu që fakti se jeta ekziston provon se ai është i vërtetë.¹³

Dhe për disa, ‘evolucionin është fakt; pasi ‘ai është fakt se nuk ka Perëndi’. Në mënyrë logjike, sipas tyre, jeta duhet të ketë lindur përmes proceseve natyrore.

Shënimet

- 1 Megjithatë, shkencëtarët kreacionistë mund të argumentojnë se një dëshmi okulare është në dispozicion, pasi Perëndia ka dhënë dëshmi për veprën e Tij të krijimit në Bibël.
- 2 **Derek V. Ager**, ‘The Nature of the Fossil Record’, *Proceedings of the Geologists’ Association*, 87/2 (1976), fq. 131–160.
- 3 **William B. Provine**, ‘A Review of Teaching about Evolution and the Nature of Science’, *National Academy of Sciences*, 18 February 1999, te: web.archive.org/web/20040709130607/fp.bio.utk.edu/darwin/NAS_guidebook/provine_1.html.
- 4 **Richard Lewontin**, ‘Billions and Billions of Demons’, *The New York Review*, 9 January 1997, fq. 31.
- 5 **Paul S. Moorhead** dhe **Martin M. Kaplan**, (eds.), *Mathematical Challenges to the Neo-Darwinian Interpretation of Evolution* (Philadelphia: Wistar Institute Press, 1967).
- 6 Po aty. fq. xi.
- 7 **Murray Eden**, ‘Inadequacies of Neo-Darwinian Evolution as a Scientific Theory’, Po aty. fq. 109.
- 8 **Paul Davies**, ‘Life Force’, *New Scientist*, 1 (1999), fq. 27–30.

A është evolucioni në pajtim me Kristianizmin?

- 9 **Paul Davies**, *The Fifth Miracle* (London: Penguin, 1999), fq. 100.
- 10 Cited in **Robert C. Cowen**, 'Biological Origins: Theories Evolve', *Christian Science Monitor*, 4 January 1962, fq. 4.
- 11 **Rodney Stark**, *For the Glory of God: How Monotheism Led to Reformations, Science, Witch-hunts and the End of Slavery* (Princeton: Princeton University Press, 2003), fq. 176.
- 12 *Expelled: No Intelligence Allowed* (video; Premise Media Corporation, 2008), te: premisemedia.com; **Jerry Bergman**, *Slaughter of the Dissidents* (Southworth, WA: Leafcutter Press, 2008).
- 13 **Phillip Johnson**, *Darwin on Trial* (2nd edn.; Downers Grove, IL: InterVarsity Press, 1993), fq. 123.